



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 10.

Prishtinë, më 6.05.2015, në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

**të mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim me
Ambasadorin e Misionit të OSBE në Kosovë, Z. Jean- Claude Schlumberger**

Në mbledhje morën pjesë: Saša Milosavljević, Agim Ceku, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Jasmina Živković, Čerim Bajrami dhe Danush Ademi .

Munguan: Mufera Sinik, Rrustem Berisha, Milka Vuletić, Slavko Simić dhe Veton Berisha.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë : Ambasador i OSBE-së në Kosovë Jean- Claude Schlumberger, drejtor i OSBE-së Christofer Tuetsch, zyrtare e departamentit për politika Drita Gjeli, përfaqësuese e OSBE-së Ardiana Gashi, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Ilyas.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatore - Natasa Prica-Tishma, Zyrtare e lartë e fushës- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Saša Milosavljević, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim njoftues me Ambasadorin e Misionit të OSBE në Kosovë, shkëlqesisë së tij Z. Jean- Claude Schlumberger;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesuesi– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

Kryesuesi, fillimisht shpreh falenderim misionit të OSB-së, për iniciativën dhe gatshmërinë e mbështetjes së Komisionit për të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthim. Theksoi se në Komision ekziston frymë e mirë pune, sepse me përgjegjësi adresohen të gjitha çështjet të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e interesave të komuniteteve që jetojnë dhe veprojnë në Republikën e Kosovës.

Kryesuesi, fjalën ia dha ambasadorit të OSBE-së, në lidhje me ofrimin e mbështetjes së Komisionit.

Ambasador i Misionit të OSBE-së në Kosovë, **Jean- Claude Schlumberger**, Ne jemi e vetmja organizatë ndërkombëtare që është e përfshirë drejtpërdrejt në punën e Kuvendit, në veçanti punën e këtij Komisioni në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe çështjen e kthimit.

I njoftoi anëtarët e komisionit, se misioni ynë ka filluar me një sërë aktiviteteve, siç janë: me 4 maj është organizuar mbikëqyrja e buxhetit në bashkëpunim me anëtarët e komunitetit joshumicë. Kemi organizuar punëtorinë në Shtëpi dhe Graçanicë për komunitetin Rom. Kemi në plan që të vazhdojmë bashkëpunimin, në mënyrë efektive të bëhet monitorimi i zbatimit të ligjeve dhe monitorimi i institucioneve.

Ne jemi të interesuar të kontribuojmë në punën e grupeve punuese lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjeve si në vijim: Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligjin për Fshatin Hoçë e Madhe, Ligjin për Shërbyesit Civil dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Gjithashtu, planifikojmë edhe aktivitete shpesh, organizimi i pesë punëtorive në veri të Kosovës dhe një në Prizren, në prani të një deputeti të Kuvendit, i cili përfaqësonë komunitetin jo shqiptarë në Kosovë. Poashtu, do të ofrojmë ndihmë edhe grupit punues lidhur me monitorimin e Ligjit për Financimin e pushtetit lokal.

Kryesuesi, fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit për diskutuar për pikën e rendit të ditës.

Agim Çeku, shpreh vlerësimin e tij të lartë për mbështetjen e OSBE-së në ndërtimin e një shoqërie multietnike në Kosovë dhe në ndërtimin e institucioneve të reja të Kosovës, si në nivel qendror dhe atë lokal. Ai theksoi se prania e vazhdueshme e përfaqësuesve të OSBE-së, është impakt për Komisionin nga se lehtëson punën gjatë monitorimit të ligjeve, ekspertizave të ndryshme.

Komisioni e mirëpret gatshmërinë e OSBE-së edhe në mbështetje të aktiviteteve tjera, siq janë organizimi i vizitave në vendet rajonale me qëllim të marrjes së përvojave në trajtim të drejtë të komunitetit pakic. Duke u njoftuar me këto praktika, komisioni mund të marrë inisiativë në ndërtimin e mekanizmave të reja, plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve ekzistuese.

Konsideron, se për komision është me rëndësi që misioni i OSBE-së të organizojë workshop pune, lidhur me monitorimin e ligjeve, të bazuara në planin e punës së Komisionit, për vitin 2015.

Çerim Bajrami, përshëndet pjesëmarrjen e ambasadorit Jean- Claude Schlumberger dhe stafin mbështetës. Njëherit falënderohet për punën që aktualisht zhvillon misioni i OSBE-së në Kosovë dhe që do të zhvillojë edhe në të ardhmen. Ai përkrah iniciativën e kolegut Çeku, në lidhje me një vizitë konkrete, gjegjësisht kontakt me komisionin homolog, me grupet parlamentare të vendeve në rajon, kjo do të jetë për ne një përvojë e mirë për krijimin e një bashkëpunimi të ri.

Sipas mendimit të tij, më rëndësi të veçantë është formimi i grupit punues në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil. Konkretisht neni 11. i këtij Ligji, ka të bëjë me përqindjen e punësimit të anëtarëve të komunitetit jo shumicë, në kuadër të institucioneve të nivelit qendror. Kosideron se në këto institucione, numri i të punësuarve të këtij komuniteti është shumë i vogël.

Sipas mendimit tonë, shqetësues është çështja e cila ka të bëjë me komunitetet tjera joshumicë, përveç komunitetit serb, se në vende të komunitetit boshnjakë, romë, ashkalinjtë, egjiptianët dhe turqit kryesisht të punësuar një numër të shqiptarëve në bazë të deklaratave të rreme që ishin gjoja pjesëtarët e këtyre komuniteteve pakicë .

Ajo çfarë na shqetëson ne, ndërlidhet me çështjen që ka të bëjë me komunitetet tjera joshumicë, me përjashtim të komunitetit serb, në vend të komunitetit boshnjakë, romë, ashkali, egjiptianë e posaçërisht të komunitetit turk, të punësuar janë një numër i konsiderueshëm i komunitetit shqiptarë, me deklaratë kinse janë pjesëtarë të komunitetit pakicë. Në kuadër të kësaj problematike, grupi punues do të ndërmerr hapa konkretë. Shpresojmë që për zgjidhjen e kësaj çështjeje të kemi përkrahjen e plotë të OEBS-së dhe të institucioneve tjera.

Gjithashtu, propozoi që në bashkëpunim me OSBE-në në Prishtinë të organizohet një mini konferencë, ku do të marrin pjesë anëtarët e Komisionit, përfaqësues të institucioneve si dhe përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare, në mënyrë që të sublimohen rezultatet e punës sonë, më pas, e njëjta do të prezantohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës,

Danush Ademi, fillimisht përshëndeti pjesëmarrjen e ambasadorit të misionit të OSBE-së, në Kosovë dhe administratën përcjellëse. Shprehu mendimin e tij se përkrah idenë e kolegut Agim Çeku, lidhur me vizitën e cila do të na shërben në marrjen e përvojave të vendeve tjera, me qëllim të adresimit të drejtë të interesave të komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Sa i përket Ligjit për Shërbimin Civil, sugjeroi që gjatë monitorimit, grupi punues të përqendrohet në çështjen e punësimit të komuniteteit jo shumicë. Gjithashtu, përmendi edhe Ligjin për Qeverisje Lokale dhe se ka njohuri se ekziston një departament i OEBS-së e cila përcellë punën e monitorimit të këtij Ligji. Sipas mendimit të tij, i njëjti ligji nuk është duke u zbatuar në praktikë.

Jasmina Živković, tha se prej fillimit, ka qen shumë aktive misioni i OSBE-së në Kosovë. Dhe tash, pas gjashtëmbëdhjetë viteve të konfliktit, janë arritur të formohen institucionet, pjesë e të cilit janë edhe përfaqësuesit e komunitetit serb dhe të komuniteteve tjera jo shumicë. Ajo çfarë i bën komunitete të jetë më aktive, janë arsytet që të ketë ndikim të caktuar në institucionet Kosovare.

Në fjalën e saj tha, se detyrë kryesore e Komisionit është mbikëqyrja e implementimit të ligjeve. Në fakt, deri sot nuk kemi arritur të dalim me një raport përfundimtar. Në mandatin e kaluar, komisioni ka bërë mbikëqyrja e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjit për Fshatin Hoça e Madhe, dhe ka pas mbështetjen e plotë të OSBE-së.

Problem tjetër shqetësues është Ligji për Verifikimin e Pronës, që është e ndërlidhur me marrëveshjen e dialogut Prishtinë - Beograd. Është skeptike lidhur me implementimin e këtij ligji, sepse me të njëjtin vijnë në kundërsht të drejtat themelore të njeriut- e drejta në pronësi. Ajo përmbylli fjalimin duke thënë se ekzistojnë edhe çështje tjera, zgjidhja e të cilave reflektohen në punën e komisionit dhe shpreson se me bashkëpunim të OSBE-së, të gjendet forma më e mirë që ligjet të jenë të implementueshme në praktikë.

Agim Kikaj, përshëndeti ambasadorin, dhe njëherit pajtohet me paraqitjen paraprake të kolegëve. Kur bëhet fjalë për zbatimin e ligjeve është një çështje problematike, sepse institucionet demokratike në Kosovë janë të reja. Komisioni, ka për obligim të bëjë pjesën e vet të punës gjatë procedurave të monitorimit të ligjeve.

Duke pasur parasysh bashkëpunimin e deritashëm të misionit të OSBE-së, shpreson se përkrahja e njëjtë nuk do të mungoj edhe në të ardhmen. Sa i përket vizitave, me shembuj të praktikave në rajon, për ne do të jetë përvojë shumë e dobishme, pasi ndërlihet me bashkëjetesën e komuniteteve.

Në fjalën e tij tha se në kuadër të përgjegjësisë së saj, Komisioni ka formuar grupet punuese, që do të monitorojnë implementimin e ligjeve dhe në fund do të dalë me raporte përfundimtare, për Kuvend.

Fisnik Ismaili, shfrytëzoi rastin të falënderojë pjesëmarrjen e OSBE-së. Me që kolegët pothuajse i thanë të gjitha, të njëjtat nuk do ti përsëris. Ishte i mendimit që në të ardhmen do të kemi një bashkëpunim frytëdhënës, të mirë, afatgjatë me misionin e OSBE-së. Gjithashtu, ishte i mendimit që komuniteti joshumicë, do të trajtohet në mënyrë të barabartë, pa përjashtime.

Kryesuesi, konsideron se Kosova ka ligje të mira në lidhje me çështjen e komunitetit jo shumicë, por thelbi qëndron në implementimin e tyre. Ai theksoi se për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, atëher Kosova efektivisht duhet t'i përmbush të gjitha kriteriumet legjislativë.

Si propozim konkret i tij ishte që grupet punuese të japin kontributin e tyre maksimal, me propozime konkrete dhe në fund Komisioni të dal me raport real, objektiv, me qëllim të përmirësohet implementimi i zbatimit të ligjeve.

Ne fund, shfrytëzoi rastin të falënderojë ambasadorin për organizimin e trajnimit për deputet jo shqiptar, me temën "Mbikëqyrja e buxhetit në nivel lokal". Ai shtoi se bashkëpunimi ynë me misionin e OEBS-së do të jetë shumë i domosdoshëm edhe në periudhat e ardhme.

Ambasadori- Jean- Claude Schlumberger, ju falënderoj për komentet tuaja dhe njëherit përkrah idenë e bashkëpunimit me këtë komision. Ai tha se prania jonë në terren është njëra prej detyrave kryesore dhe se do të japim përkrahje të plotë gjatë monitorimit të zbatimit të ligjeve. OSBE-ja, është duke bërë përpjekje për ti kyq disa deputet në takime me kolegë të rajonit, me qëllim të shkëmbimit të përvojave të ndërsjellta.

Siç u përmendë edhe më lartë, problem kyq është monitorimi i zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil. Është e qartë se ky ligj nuk është duke u zbatuar në masë të duhur, këtë çështje e kemi evidentuar në raportin e publikuar, më herët. Ne ju kemi bërë thirrje të gjitha institucioneve në nivele të ndryshme, për të punuar në zbatimin e këtij ligji.

Kur është fjala për Ligjin për Verifikimin e Pasurive, ne duhet ti kemi propozimet e juaja, në mënyrë që të ofrojmë komentet konkrete. Misioni ynë ka dhënë komente lidhur me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, dhe mendojmë se nuk është i konkretizuar, nga se nuk janë bërë konsultime gjegjëse, para miratimit nga Qeveria.

Në fjalën përmblledhëse tha, se është e një rendësi të veçant çështje e zgjedhjes së Ombudspersonit, i papenguar nga Kuvendi.

3. Të ndryshme

3.1 Danush Ademi – Vërejtja e tij ishte se nuk është duke u zbatuar në plotëni Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Përkatësisht kur bëhet fjalë për zgjedhjen e nënkryetarëve të Komunave dhe përfaqësues të zyrave lokale për komunitete, të cilët duhet të jenë të zgjedhur nga rrada e komunitetit jo shumicë.

Andaj kërkoi që në takimin e rradhës të ftohet ministri i Vetëqeverisjes Lokale që të rapotojë për shkallën e zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe lidhur me procedurat e ligjmëris së akteve të komunave.

Pas diskutimit të dhënë nga Danush Ademi, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Përfundim

Obligohet administrata për mbështetje të komisionit që të dërgojë ftesë ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) Ljubomir Maric , për të raportuar për zbatueshmërin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me çështjen e zgjedhjes së nënkryetarëve të Komunave dhe përfaqësuesit e zyrave lokale për komunitetin jo shumicë.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit, do të njoftoheni paraprakisht.

3.2 Agim Çeku –theksoi se në mbledhjen e kaluar, Komisioni ka marrë qëndrim që të realizojë vizitë pune, në Republikën e Malit të Zi dhe të Kroacisë.

Lidhur me këtë çështje, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim përcaktoi listën e deputetëve për vizitë në Republikën e Kroacisë dhe Republikën e Malit të Zi, si në vijim :

- a) Lista e vizitës në Republikën e Malit të Zi: Sasa Milosavljevic, Agim Çeku, Agim Kikaj, Myfera Sinik, Qerim Bajrami, Veton Berisha, Milka Vuletic, nga stafi mbështetës i Komisionit, Drita Çarkaxhiu.
- b) Lista e vizitës në Republikën e Kroacisë: Sasa Milosavljevic, Agim Çeku, Rustem Berisha, Fisnik Ismaili, Qerim Bajrami, Slavko Simic, Danush Ademi, nga stafit mbështetës i Komisionit, Natasa Prica-Tisma.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetje të Komisionit

Kryetari i Komisionit

Saša Milosavljević